



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Ligji nr. 03/l-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 17.04.2020, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**VENDIM**  
**PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSAVE DHE QIRASË KOMUNALE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për shkak të përhapjes së pandemisë botërore –COVID 19 që ka rezultuar me pezullimin e shumë veprimtarive punuese do të lirohen nga pagesa e obligimeve komunale për vitin 2020 personat fizik dhe juridik si vijon:

1. Lirim nga pagesa e qirasë për qiramarrësit (shfrytëzuesit) e objekteve në pronësi të Komunës,
2. Lirim nga pagesa e taksës komunale për hapësira publike , terasa dhe për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e objekteve të përkohëshme për të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike,
3. Lirim nga pagesa e qirasë joprofitabile për të gjithë përfituesit e banimit social,
4. Lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e parkingjeve në pronësi të Komunës për të gjitha automjetet taksi të Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit të Komunës , Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15Nr. 360-16851

Lipjan, më 17.04.2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

